



PROCESVERBAL 3/2024

I Mbajtur në takimin e III- të të rregulltë të KPF-së me datën **27.03.2024**, në sallën e vogël të takimeve në ora 10⁰⁰ nën kryesimin e Kryesuesit të KPF-së, Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, OJQ-ve dhe Zyrtarës për informim.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. z. Xhavit Zariqi, Kryesues;
2. z. Arian Imeri, Anëtar
3. znj. Lumnije Morina, Anëtare;
4. znj. Mimoza Pajaziti, Anëtare;
5. z. Lulzim Abazi, Anëtar;
6. z. Brahim Osmani, Anëtar;
7. znj. Shqipe Jashari, Anëtare;
8. znj. Hatixhe Bungu Qerimi, Anëtare;
9. z. Flamur Istrefi, Anëtar dhe

Drejtorët e drejtorive;

1. z. Sabri Murseli, Drejtor i Drejtorisë së Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë;
2. z. Kemajl Emini - Drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe
3. z. Balton Dërguti, Drejtor i Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit,

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishëm, anëtarë të kuvendit, shoqëria civile, Drejtor të drejtorive, pra po fillojmë me mbledhjen e III-të të rregullt të KPF-së, besoi që materialin e keni marr me kohë dhe ju dëshiroi mirëseardhje në mbledhjen e KPF-së dhe propozojë këtë rend dite:

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KPF-së;
2. Miratimi i rendit të ditës;

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të KPF-së;
4. Raport i Punës për Vitin 2023;
5. Propozim – Vendim për Plotësim – Ndryshimin e Vendimit Nr. 41, të datës 28.02.2022, për Zgjedhjen e Anëtareve të Rijnë të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB);
6. Propozim – Vendim për aprovimin e kërkesave për blerjen e banesave për të cilat ekziston e drejta e parablerjes;
7. Propozim – Vendim për këmbimin e ngastrës kadastrale; 492-3 Z.K. Ferizaj, pronë private, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 690-3 Z.K. Talinoc i Jerlive, pronë e Komunës së Ferizajt;
8. Propozim – Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të ngastrave kadastrale; 376-1 dhe 378-3 Z.K. Nerodime e Ulët, pronë private, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 992-0 Z.K. Talinoc i Muhaxherëve, pronë e Komunës së Ferizajt;
9. Propozim – Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të ngastrave kadastrale; 667-1 dhe 667-2 Z.K. Talinoc i Muhaxherëve, pronë private, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 286-0 Z.K. Talinoc i Muhaxherëve, pronë e Komunës së Ferizajt;
10. Propozim – Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të ngastrave kadastrale; 532-5 Z.K. Talinoc i Jerlive, pronë private, me pjesën e ngastrës kadastrale 690-3 Z.K. Talinoc i Jerlive, pronë e Komunës së Ferizajt dhe
11. Të ndryshme.

Pika shtesë :

1. **Propozim – Vendim për anulimin e vendimeve për dhënien me qira të banesave në pronësi të komunës.** 9 vota për, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim, pra miratohet rendi i ditës.
2. **Propozim – Vendim për miratimin e Plotësim Ndryshimin e Rregullores 01. Nr. 23 të datës 28.02.2020.** 9 vota për, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim, pra miratohet rendi i ditës.

Pika 1

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KPF-së; 9 vota për, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim, pra miratohet rendi i ditës.

Pika 2

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – Lexoi pikën e rendit të ditës dhe theksoi se a ka dikush të flas për rend dite, fjalën ia kaloi Drejtorit Sabri Murseli.

Sabri Murseli – Faliminderit Kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishmit kam një propozim të ri që ka të bëjë me Propozim – Vendim për anulimin e vendimeve për dhënien me qira të banesave në pronësi të komunës në vitin 2014 dhe 2017 kjo për fakti se Ministria qysh në Vitin 2017 ja kanë aprovu kuvendit këtë vendim dhe që kemë kërkuar nga ministra për refuzim të këtij

vendimi në Vitin 2017, mirëpo për shkak të natyrës së ndashmërisë të këta janë procesi, e pruna sot që ta diskutojmë që të anulohen këto vendime, të fillojmë me një proces të rinjë sepse një vendim i tillë nuk është për shfrytëzim, të gjithë këta përfitues nuk kanë hi në këto banesa, është mirë me pastru si çështje mandej me marr një vendim qysh u marr 2013, një vendim për lirim e atyre pronave në mënyrë që të vazhdohet me të njëjta prona me identifikim, rexhistrim në kadastrë e mandej me fillu një procedurë të re në bazë të ligjit që ka hi në fuqi 2022, mos gabofsha për çështjen e zgjidhjeve të familjeve dhe sakt mund të jetë kush është përfitues për rastin e banesave, faliminderit.

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – Faliminderit drejtor, pra është Propozim – Vendim për anulimin e vendimeve për dhënien me qira të banesave në pronësi të komunës, dikush tjetër, urdhëro.

Kemajl Emini – Përshëndetje për të gjithë, Kryesues, drejtor, media, kemi një Propozim – Vendim për miratimin e Plotësim Ndryshimin e Rregullores 01. Nr. 23 të datës 28.02.2020, për përcaktimin e rregullimit të orarit të punës të barnatoreve në territorin e Komunës së Ferizajt, vetëm pak me vonesë por për shkak është detyruar ta bisedojmë përkatësisht me bizneset, kështu që mbas debatit me qytetar dhe formimit të grupit punues dhe me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik me Drejtorin Balton që kemi ba debate me qytetar, atëherë pak ma shumë kemi nxjerr një draft me Ministrinë e shëndetësisë edhe kemi ardhë me një përfundim për një orar.

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – Faliminderit drejtor, pra kemi edhe dy propozime të reja;

- Propozim – Vendim për anulimin e disa vendimeve për dhënien me qira të banesave në pronësi të komunës. 9 vota për, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim, pra miratohet propozimi.
- Propozim – Vendim për miratimin e Plotësim Ndryshimin e Rregullores 01. Nr. 23 të datës 28.02.2020. 9 vota për, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim, pra miratohet propozimi.

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – Fillimisht a jeni për propozimin paraprak për rendin e ditës, kush është për; 9 vota për, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim, kush është qw tw kaloi Propozim – Vendimi për anulimin e disa vendimeve për dhënien me qira të banesave në pronësi të komunës; 9 vota për, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim, faliminderit.

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – Kush është për Propozim – Vendimin për miratimin e Plotësim Ndryshimin e Rregullores 01.Nr.23 të datës 28.02.2020, që të kaloi në kuvend, kush është për; 9 vota për, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim.

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – Pra po fillojmë me rendin e ditës, besoi që jeni të gjithë prezent, kush është për aprovimin e rendit të ditës; 9 vota për, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim, pra miratohet rendi i ditës.

Pika 3

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të KPF-së, a ka dikush ndonjë çështje për procesverbalin, kush është për miratimin e procesverbalit; 9 vota për, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim, pra miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar, vazhdojmë me pikën e IV –të.

Pika 4

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – Raport i Punës për Vitin 2023, besoi që në KPF s’kemi çka të diskutojmë me Raportin, po e procesojmë në kuvend, e aty kemi çka debatojmë për Raport, a të diskutojmë aty drejtor, apo në përgjithësi është mirë që secili që del me diskutu të jetë në rregullë, atëherë kush është që të kaloj për kuvend ky Raport; 9 vota për, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim, pra miratohet Raporti i Punës për Vitin 2023, që të kaloj në kuvend, po vazhdojmë me pikën V-të të rendit të ditës.

Pika 5

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – Propozim – Vendim për Plotësim – Ndryshimin e Vendimit Nr. 41, të datës 28.02.2022, për Zgjedhjen e Anëtareve të Rijnë të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), kush është këtu prej drejtorave që na sqaron pse duhet ta ndryshojmë këtw.

Nënkryetari i KK-së Lulzim Aliu - Kryesues këtu nuk është cekur bash sakt kush është prej anëtarëve, por ky është KKSB-ja dhe ka një numër të caktuar të anëtarëve dhe të gjithë e kanë një përfaqësues, por është edhe një përfaqësues prej Këshillit të prindërve, nëse nuk gaboi është prej Shtimës edhe patjetër duhet me qenë prej Komunës së Ferizajt d.m.th. është procedurë ligjore, kjo është miratim formal që na u ka propozu nga këshilli, nuk është që na këna pas referencë me propozu, por na kanë propozu ata.

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – Faliminderit Nënkryetar, pra bëhet për ndryshimin e një anëtari në KKSB-së e jo ndryshimin e vendimit.

Nënkryetari i KK-së Lulzim Aliu – Është shkruar gabimisht edhe për zgjedhjen e anëtarëve të rinjë, ku është propozu vetëm një anëtarë, e u kanë dashtë për ndryshimin e një anëtari në KKSB.

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – Kush është për këtë ndryshim, 9 vota për, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim, pra miratohet Propozim – Vendim për Plotësim – Ndryshimin e Vendimit Nr. 41, të datës 28.02.2022, për Zgjedhjen e një Anëtari të Rijnë të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) që të kaloj në kuvend, faliminderit, po fillojmë me pikën e VI-të të rendit të ditës.

Pika 6

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – Propozim – Vendim për aprovimin e kërkesave për blerjen e banesave për të cilat ekziston e drejta e parablerjes, kush është të diskutoi për këtë pikë të rendit të ditës, urdhëro drejtor.

Sabri Murseli – Ky propozim – Vendim ka të bëjë për miratimin e Vendimit të komisionit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta e blerjes, këto banesa kryesisht që janë në këtë propozim kanë pas kontrata për qira të banesave dhe mbas luftës nuk kanë pasur mundësi me i ba këto pagesa, në kuadër të këtij vendimi i ki edhe disa vendime që janë nda për ushtarët e UÇK-së 2 ose 3 edhe do persona që e kanë fituar të drejtën, kanë ba me përqindje të banorëve, e kanë ba mbindërtim dhe në bazë të ligjit për kadastër nëse ekziston një vendim i ri për parablerësin e banesave i jepet e drejtë, kështu që prej 21 kërkesave, komisioni i ka arrit me i shqyrtu, mos gabofsha 9 kërkesa të cilat i plotësojnë kriteret, prej tyre janë formu ose 1 ose 3 nuk po më kujtohet sakt, kanë arrit me i kriju mundësit për shkak të kohës së ngushtë, është Ligji që i lejon 100m² të banesës, nuk mundemi me pa sa është kostoja që është nënshkru kontrata për dhënie të shfrytëzimit të përherëshëm, nëse paguhet çmimi menjëherë mbrenda 15 dite kanë 20% zbritje por edhe mirret edhe shkalla e amortizimit, por nuk i kena ato detaje, tash në bazë të praktikës, AKP-ja so tu i aprovu të gjitha ato kërkesa me i pru në kadastër me i realizu, kena pas edhe shkresë prej Ministrisë së Punëve të Brendëshme për me i realizu, nuk është kërku pse nuk po aplikohen këto kërkesa këtë formë, këtë raport dhe në këtë propozim që ta sjellim në kuvend që të miratohen, sepse simbas ligjit ju njihet ajo e drejtë, ju është vazhduar ajo e drejtë dy herë në vit prej ministrit dhe na në mënyrë ligjore duhet me e procesu këtë vendim, faliminderit.

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – Faliminderit Drejtor, a ka dikush të diskutoi për këtë pikë.

Shqipe Jashari – Përshëndetje për të gjithë, drejtor unë kisha dashtë për me precizue pse nuk i kena këto vendime, ose lejet e ndërtimit për të gjithë, vendimin e komisionit pse nuk e kena për secilin kërkesë, nuk e këna të bashkangjitur vendimin për me i pa edhe na këtu, te kërkesa e 6 –të me numër 2785 / 23, kërkesë është ky emër, ndërsa tek arsyetimi është tjetër person, i ipet ushtarit Fadil Ademaj d.m.th. po i njëjti person i merr dy banesa, pse me të njëjtin numër të protokollit rasti i tij është me emër Fadil Ademaj, ku Fadil Ademaj e ka edhe tjetër banesë edhe me numër 21254/23, me qfar kriterë përveç këtyre që janë nda këto banesa duhet me u procesu dhe qysh me i vërtetu na, që këto banesa me i procesu që dokumentat nuk na kenë sjell hiç.

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – Faliminderit Shqipe, Dikush tjetër.

Sabri Murseli – Të gjitha këto shënime janë në dosje, ta shofim cilat nuk janë ba kopje dhe nuk janë në dosje dhe se duhen të jenë gjithë qysh, sa i përket kësaj, është gabim teknik, te arsyetimi është sakt simbas kërkesës dhe se është lëshim teknik wshtw nw arsyetim, e në dispozitiv është e sakt, simbas kërkesës së 6- të kësaj Arsim Hamiti është Fadil Ademaj, kërkesa 2785/23, është gabim teknik, 2751 ka mbetë këtu lëshim teknikë te arsyetimi.

Shqipe Jashari – A është lëshim teknik te emri apo te banesat e ndryshme.

Sabri Murseli – Te arsyetimi është gabimisht se ka mbet kopë paste, ndërsa në dispozitiv është e sakt.

Shqipe Jashari – Nuk është kopë paste, te Fadil Ademaj e ka tjetër banesë, e nuk e ka kështu.

Sabri Murseli – Për Arsim Hamitin jam tu folë e jo për kështu, Fadil Ademaj është me numër 5, banesa me numër 174511119-0 me sipërfaqe 55 m² në dispozitiv, Rasim Hamiti është me numër 6 kuqësia 27851-lokacion 23 të datës 24.03.23 për banesë 34 m² 174511110-0 a e ke të qartë numrat e banesës, 19 e ka Fadil Ademaj 10 e ka Rasim Hamiti.

Shqipe Jashari – Materiali duhet të na vijë.

Sabri Murseli – Materiali do t'iu vijë se komplet shkresat janë në material dhe pa kërkesë pa vendim nuk kanë mundur me ardhur këtu, ju bajmë kopje dhe ju sjellëm.

Shqipe Jashari – Në seancë nuk duhet të na vijen këto gabime, se i njëjti person përfiton dy banesa.

Sabri Murseli – Dispozitivi ta arsyeton, mundet me pas gabime por me dispozitiv është e sakt.

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – Drejtor a banë me ta ba një pyetje?, nëse kjo çështje është rregulluar me ligj, qysh e thatë ju pse me ardhë në kuvend kështu, pse nuk përfshihet në bazë të ligjit, e te na me ardhë në kuvend, kur ne nuk mundemi me ndryshu kurgja nëse me ligjë është e rregullime kjo gjë, simbas arsyetimit kjo duhet të kalojë në kuvend dhe të vlerësohet.

Sabri Murseli – Në parim çdo bartje, zona e tretë e pronës publike ka qenë në praktik edhe mbas lufte edhe në bazë të ligjit, unë nuk besoj që kanë ba një shitje të banesës pa e miratuar, AKP-ja i ka bartjet e kërkesave të komisionit të organit të shkallës së dytë, raporti i komisionit ka dal si organ i vetëm, me që ka të drejtë pa e procesu në kuvend nuk ndërmerr asgjë, kur miratohet prej kuvendit, mirret vendimi i sakt për aprovim, në bazë të atij vendimi, procesohen të drejtat, ndërsa kontratën e merr kuvendi dhe mandej kryetari dhe mandej bëhet verifikimi, a ka dikush drejt ma shumë edhe pse i kemi ba edhe verifikimin e këtyre banesave.

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – Drejtor këto banesa a janë pronë e komunës apo jo.

Sabri Murseli – Për momentin jo, këto banesa kryesues me kontrata të shit blerjes janë kanë në shfrytëzim të përhershëm të personave.

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – Unë po ju kuptoj, mbasi nuk janë pronë e komunës, pse ne me u marr me këto.

Sabri Murseli – Realisht janë shku në bazë të komunës për banim të përhershëm, tani i kanë dhanë vendime në shfrytëzim të përhershëm, për këtë arsye kjo drejtë e shfrytëzimit paguhet në vlerë të pronësimit që është paguar qiraja.

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – D.m.th. ja kena dhanë në shfrytëzim e tash po ja falim.

Sabri Murseli – Jo nuk po ja falim, këto janë dhanë para dhe mbas luftës dhe se komuna si organ e proceson procedurën.

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – Unë mendoi se me shumicë të votash, këtu bahet legalizim ose ligjësim i padrejtësive që janë ba, ligjësim i keqpërdorimeve që janë ba, njëherë i kanë uzurpu e mandej edhe janë legalizu dhe janë shfrytëzu edhe kanë pas vendim e tash ne këtu duhet krejt me i legalizu, nuk ka logjikë kjo punë, nëse pyetna unë nuk e kaloi këtë pikë edhe me zanë këtë pronë edhe me keqpërdor edhe me mbindërtu edhe tash me kuvend me i legalizu nuk është normale, le të vazhdojnë qysh ja kanë qit rrethin le t'ia bajnë, 25 vjet i kanë përdorë, e mbas 25 vjetëve kërkojnë t'ia bëjmë legale, nuk ka logjikë kjo punë, ju sit ë doni votoni, unë jam kundër kësaj personalisht, vendëse na me ju marr që i kanë keqë përdorw, e na me ja legalizu, e atëherë njerëzit e ndershëm nuk kanë ndërmarr asnjë veprim, këta persona janë tregu shumë të menqur edhe shteti duhet me u marr me ta, nuk jamë tu tu drejtu ty drejtor, mos të keqë kuptohemi, nuk kam asgjë personale, veç e kam në parim, nuk është e drejtë, po ju la, secili e keni të drejtën me marr vendime.

Brahim Osmani – Unë e kam një pyetje për drejtorin, këto banesa i kanë gëzu, banesat mbi ndërtim, a janë banesat e tyre veç si pyetje e bana.

Sabri Murseli – Brah, ligji për katastër tash e njehë vendimin për legalizim, se legalizimi i objektit për mbindërtim bëhet me pëlqim të banorëve, nuk mundesh me ndërtu pa pëlqimin e banorëve, qajo pjesa e ndërtimit duhet me u legalizu se ligji ja njeh, tash problem është, nëse ishte toka nën objekt dhe është e personit privat, nuk kishte ardhë në komunë hiç, e kishte qitë në emer të vet private, tash për mbindërtim komunës ka me ja pagu 100 euro për m².

Brahim Osmani – Unë personalisht që jam kundër, du me tregu një arsyetim se ka shumë ushtar të ndershëm të UÇK-së dhe të tjerë të cilët nuk i kanë kushtet dhe ju kanë dhanë mbi ndërtim.

Sabri Murseli – Këtu mbindërtim nuk i kanë ushtarët e UÇK-së, ata i kanë vendimet, e keni përshkrimin.

Brahim Osmani – Ky propozim nuk duhet me kalu as për seancë e leje me u procesu në kuvend.

Arian Imeri – Këto janë vendimet e personave të UÇK-së, që ju kanë dhanë vendimet e përhershme dhe disa personave edhe para luftës, pra njerëzit nuk duhet mi lane, duhet me ju ba zgjidhje, sa e kuptova drejtorin këta kanë kontrata të përherëshme që i kanë ba me institucione, që kanë qenë edhe para luftës edhe i kanë ba një kontratë që nëpërmes të institucioneve me këste dhe i kanë pagu ato banesa, nuk di qysh i kanë ba ato punë para lufte të viteve 90-ta, andaj ky proces ka mbet në gjysë për arsye të luftës, andaj mendojë ta procesojmë në seancë dhe që mendoj që janë të domosdoshme dhe ta shqyrtojmë edhe njëherë duke mos përmendur as emra dhe në parim cila është zgjidhja tjetër, nuk shohë mundësi që mujna me i marr këto banesa, faliminderit.

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – Dikush tjetër, urdhëro Nënkryetar.

Lulzim Aliu - E para, propozimi është qysh e ka shkru, Vendim për aprovimin e kërkesave për blerjen e banesave për të cilat ekziston e drejta e parablerjes, është një dishka që është e bazuar me ligj nuk është dishka falë që nuk mundet me u ba, këta qysh e pashë janë njerëzit që janë tu banu qe 25 vjet e më shumë dhe tani kjo është e drejt e blerjes të cilën na nuk duhet me mohu, por drejtori e përmeni një çështje, në qoftëse prona është private mbindërtimet legalizohen pa e pyetur kuvendin hiç, sepse është një pronë private, problemi ma i madh në Kosovë që është tek objektet kolektive në të cilat janë ndërtu objektet, është privatizu banesa por toka ka mbet në emër të komunës, është një ligj për objektet në bashkëpronësi, e cila thotë që objekti kur është i vendosur me një parcelë, parcela është pronë e krejtë banorëve të atij objekti, sa banesa kanë sa përqindje i kanë qaq është objekti, kur asnjëherë në asnjë vend të Kosovës nuk është përdorë ky ligj nw kadastër nuk është implementu, realisht edhe këtu shkruan se rendi është nëse donë me u ndërtu një objekt në qendër të qytetit, duhet me dal me kadastër me ju bartë të gjithë banorëve me përqindje ajo tokë, është problem serioz në tërë Kosovën, por që tha edhe Ariani a duhet me i lanë aty këta njerëz që e kanë fitu të drejtën e shfrytëzimit, e ka mbindërtu dikush me lejën e banorëve se edhe tek pjesa private dhe tek pjesa publike ai e ka ba mbindërtimin me lejën e banorëve, nuk mundet me legalizu nëse nuk e kanë marr pëlqimin e banorëve, unë mendoj që duhet me qu në kuvend dhe me ba zgjidhje, pikërisht për ata persona që mos mi lan peng dhe me probleme që kanë banuar qe 25 vjet e më tutje, nuk është privilegj që është tu ju ba dikujt, ka edhe familje të dëshmorëve dhe banor të tjerë, nuk është me rëndësi kjo, është legale dhe që duhet me përcaktu qysh e thot ligji.

Sabri Murseli – Ky ligj 2012 ka hy në fuqi, u vazhdua 2014 e tash u vazhdu afati, u vazhdua për dy vjet, brenda kësaj periudhe është pranua kërkesa, këtu nuk është telashja a po dojna na me i marr ato, banesat janë dhanë po disa nuk janë në shfrytëzim dhe duhet me shku nëpërmes gjykatës.

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – Në më dëgjofshin ata mua, le ta fitojnë me gjykatë, nëse është prona e komunës nuk është e krejt banorëve aty, nuk ka asnjë logjikë, ligji duhet me definu, nuk ka mundësi me u regjistru në kadastër prona komunale, e në të njëjtën kohë ju takon banorëve ka sa m² i kanë nuk ka logjikë kjo punë, por këto nuk mundemi me implementu, qe sa është ky ligj nuk janë implementu, nuk ka mundësi, nuk ka logjikë.

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – Kush është që të kalon në kuvend Propozim – Vendim për aprovimin e kërkesave për blerjen e banesave, për të cilat ekziston e drejta e parablerjes, 4 vota për, 5 vota kundër, pra nuk kalon pika e VI-të e rendit të ditës, le ta zgjidhin me ligj pse me u marr me këtë punë, po fillojmë me pikën VII-të të rendit të ditës.

Pika 7

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – Propozim – Vendim për këmbimin e ngastrës kadastrale; 492-3 Z.K. Ferizaj, pronë private, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 690-3 Z.K. Talinovic i Jerlive, pronë e Komunës së Ferizajt, drejtor a po na sqaron për këtë rend dite.

Sabri Murseli – Faliminderit Kryesues, Ky Propozim – Vendim ka të bëjë për këmbimin e këtyre dy pjesëve të ngastrës kadastrale; 492-3 Z.K. Ferizaj me sipërfaqe

577 m2 s' bashku me objekt me pjesën e ngastrës kadastrale 690-3 Z.K. Talinovc i Jerlive me sipërfaqe 6 ari e 91, pronë e Komunës së Ferizajt, paraprakisht është shpall interes i përgjithshëm, është bërë vlerësimi në bazë të vlerave të pronave, është caktuar edhe sipërfaqja më herët, kështu që është vlerësu edhe prej ministries, vlersimi i tij është jashtëzakonisht real, kështu që propozoi që të kaloi tutje, faliminderit.

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – Faliminderit, a dëshiron dikush të diskutoi, a jeni që të kaloi në kuvend, kush është për, 9 vota për, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim, pra kalon kjo pikë e rendit të ditës, po vazhdojmë me pikën e VIII-të.

Pika 8

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – Propozim – Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të ngastrave kadastrale; 376-1 dhe 378-3 Z.K. Nerodime e Ulët, pronë private, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 992-0 Z.K.Talinovc i Muhaxherëve, pronë e Komunës së Ferizajt, drejtor e ki fjalën.

Sabri Murseli – Faliminderit Kryesues, Ky Propozim – Vendim ka të bëjë Shpalljen Interes i Përgjithshëm të këtyre dy ngastrave kadastrale; 376-1 dhe 378-3 me qëllim të këmbimit në parim, mbasi nuk kemi mjete për shpronësim, sepse u wshtë dashtë të bëjmë për shpronësim ose për këmbim, për arsye se jemi duke planifikue të bëjmë një çerdhe në këtë parcel dhe t'i lidhë të gjitha ato fshatra, Balaj, Neredime, Manastirc, Jezerc, është afër urës së Balajve kjo parcel, është largë, realisht ka edhe vorre aty, por nuk ka shumë aty, janë 15-20 vorre që duhen të zhvarrosen, mirëpo me këtë vendim që marrim e hapim procedurën të vazhdojmë procedurën më tutje, mbasi presim që ministria planifikon me i implementu edhe këmbimin me ngastrën kadastrale 992-0 Z.K.Talinovc i Muhaxherëve, pronë e Komunës së Ferizajt, në bazë të vlerësimit të ministrisë e bëjmë këmbimin, faliminderit.

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – Kjo kërkon procedur, a ka dëshiron dikush të diskutoi.

Brahim Osmani - Faliminderit Kryesues, deshta me pyet drejtorin për shka ka ba lidhur me kete që e kanë ba Propozim – Vendimin për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të ngastrave kadastrale; 376-1 dhe 378-3 Z.K. Nerodime e Ulët, pronë private, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 992-0 Z.K.Talinovc i Muhaxherëve, pronë e Komunës së Ferizajt për arsye se komuna nuk ka planifikuar buxhet sepse të gjitha ato fshatra, Balaj, Neredime, Manastirc, Jezerc është për Çerdhe për fëmijë dhe që do të shërbej për fshatra Balaj, Neredime, Manastirc, Jezerc i eperm dhe i ulët, ngastrën kadastrale 992-0 Z.K.Talinovc i Muhaxherëve së pari e kena materialin për me i pa, se ku këmbehen pronat, e dyta nashta na nuk jena që si janë Talinovc i Muhaxherëve për me i vlerësu vlerat e tyre.

Sabri Murseli – Brahim më parë do të bëhet testimi, e ma vonë do të bëhen vlerat dhe si bien vlerat do të bëhet testimi, e jo sipërfaqe, se ky është një vendim paraprak, se janë skicat në material, afër fabrikës së ujit, e marrim edhe projektoren Brahim në kuvend për çdo rast me sqarue këto punë.

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi - Dikush tjetër, pra a jeni që të kaloi propozimi, për kuvend, kush është për; 9 vota për, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim, pra miratohet pika e VIII-të e rendit të ditës, po fillojmë me pikën e IX-të.

Pika 9

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – Propozim – Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të ngastrave kadastrale; 667-1 dhe 667-2 Z.K. Talinoc i Muhaxherëve, pronë private, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 286-0 Z.K. Talinoc i Muhaxherëve, pronë e Komunës së Ferizajt, urdhëro drejtor.

Sabri Murseli - Edhe ky Propozim – Vendim ka të bëjë me Shpalljen Interes i Përgjithshëm të ngastrave për asfaltimin e rrugës “ Rrahman Sejdeiu “ është marr kjo sipërfaqe e pronës, andaj propozoi që ka interes të përgjithshëm të ngastrës kadastrale 286-0 Z.K. Talinoc i Muhaxherëve mbas vlerësimit nga ministria dhe do të bëhet paraprakisht e të bëhet vlerësimi i të gjitha pronave dhe mandej të bëhet këmbimi, realisht në këtë formë kena shku çdo herë, por një ditë pa ardhë shkresa me konfirmu e mandej të procesohet në kuvend për vlerësim, e mandej për këmbim, kështu kemi shku çdo herë, faliminderit kryesues.

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – A ka dikush të diskutoi për pikën e IX-të, pra po e procesojmë për kuvend, kush është për; 9 vota për, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim, pra miratohet pika e IX-të e rendit të ditës, pra kalon.

Pika 10

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – Propozim – Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të ngastrave kadastrale; 532-5 Z.K. Talinoc i Jerlive, pronë private, me pjesën e ngastrës kadastrale 690-3 Z.K. Talinoc i Jerlive, pronë e Komunës së Ferizajt, edhe këtu dejtore e keni fjalën.

Sabri Murseli – Po kryesues, ky Propozim – Vendim për ka të bëjë me Shpalljen Interes i Përgjithshëm të ngastrave kadastrale, prej 23 m² me këmbimin e pjesën e ngastrës kadastrale 690-3 Z.K. Talinoc i Jerlive, arsyeja pse në këtë zonë paraprakisht të gjithëve ju kanë ba shpronësimet, mirëpo kjo pjesë ka mbet pa u shpronësu edhe përveç disave që nuk ju ka ba shpronësimi dhe janë mbet të pa definime, për këtë arsye është propozu sepse duhet të shpronësohen dhe t’iu

bashkangjiten vendimeve tjera, është sipërfaqe e vogël por propozoi që të bëhet vlerësimi e ma vonë të vjen për këmbim, faliminderit.

Kyesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – A ka të interesuar për të diskutuar, urdhëro.

34.00 Arian Imeri - Faliminderit Kryesues, e kam pa këtë si rast, te të tjerët janë fukusu me mjete monetare.

Sabri Murseli – E kena një rast si ky në “Driton Islami” si ky, për shkak buxhetit nuk po mujna me i nxjerr vendim për shpronësim, për shkak të buxhetit.

Arian Imeri – Kisha thanë me shkua në shpronësim se 23 m² me vlerw 24,000.00 euro, kishim mujt me i gjetë, përndryshe nëse i ndajmë 22 m² na bajnë dam ma shumë se sa me 23 dhe se ne mundemi me prish strukturën e pronës që në të ardhmen mundemi me shfrytëzu me një interes të përbashkët, unë e njohë të drejtën e kompensimit të pronës patjetër, sepse pa marr parasysh qysh e marrim për m² por është një pjesë shumë e vogël dhe në anën tjetër po bajna dam, faliminderit.

Sabri Murseli – Këtu nuk ka këmbim por vetëm vlerësim i pronës, mandej vendosim se çka po bajna.

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – Kush është që të kaloj për kuvend, kjo pikë e rendit të ditës; 9 vota për, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim, pra miratohet pika e X-të e rendit të ditës, vazhdojmë me pikën e XI-të.

Pika 11

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – Propozim – Vendim për anulimin e vendimeve per dhënien me qira të banesave në pronësi të komunës.

Sabri Murseli – Me numër 01.Nr.115 dhe me numër 163 të datës 11.07.2014 prej Vitit 2017 janë 37 vendime të cilat ministria ka filluar procesin me shkresën e datës 08.08.2017 plotësim të dokumentacionit u kry si proces ndërsa me 11.09.2017 ka nxerr vendim me numër të protokollit 3901-2 me numër A-195/15 përmes së cilës shfuqizon vendimet e Komisionit komunal për ndarjen e banesave për raste sociale, është shkresë e ministrisë që në bazë të kërkesës për shfrytëzim, kështu në parim që duhet me i anulë e ma vonë me i vazhdu, materialin e ki në dosje kryesues, faliminderit.

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – Kush është që të kaloj për kuvend, kjo pikë e rendit të ditës; 9 vota për, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim, pra kalon në kuvend kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – Propozim – Vendim për miratimin e Plotësim Ndryshimin e Rregullores 01. Nr. 23 të datës 28.02.2020, drejtor a mundesh me na sqaru për këtë pikë.

Kemajl Emini - Faliminderit kryesues, në bazë debatit me qytetar që patëm për zhvillim ekonomik u formua një grup punues ku janë asambleist, farmacist, inspektorati si dhe nga shëndetësia dhe bashkëbisedim me koleg edhe mjek edhe farmacist më shumë jemi bazuar në draftë pozitën administrativ të Ministrisë të shëndetësisë ku na është thënë që brenda 6 muajve ky draft propozim duhet me qenë unik që ma shumë jemi bazu në këtë draft, ku pika 6/2-1 përcaktohet për 100000 banor ditëve të shtune sa banor me qenë për barnatore dhe në të njejtën kohë edhe sa barnatore pika 6/1 për 100000 banor sa barnatore do të jenë qelë për të djelën dhe festa, në bashkëpunim me grupin punues, dhe nëpërmes të email-it që e kemi marr, atëherë kemi bërë një orar të punës së barnatoreve të shtunën prej orës 8-24, ndërsa kujdestarit prej orës 21-8.00 të kujdestarojnë këto tri barnatore të djelave dhe festave zyrtare, kujdestaria me qenë 24 orë, me kujdestaru 5 barnatore, orari i kujdestarive përgatitet nga grupi punues nga barnaret e qytetit ashtu si ka qenë, kjo është për 6 muaj, ne kemi mendu për 1 vjet por ta presim një barnatore të re që hapet, një vjetë mos me kujdestaru, qe 6 muaj oraret obligohen edhe nga barnaret edhe nga institucioni dhe punëtorët shëndetësor, faliminderit.

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – Faliminderit drejtor, a dëshiron dikush të diskutojë, a jeni që të kaloi në kuvend, kush është për; 9 vota për, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim, pra kalon në kuvend kjo pikë e rendit të ditës.

Brahim Osmani - Kryesues edhe në mbledhjen e kaluar e kemi pas në rend të ditës por për vazhdimin e komisionit për vazhdimin e vendimit për emërtim të rrugëve dhe kemi vendosë në kuvend që ky propozim të shkojë në zyre ligjore se a ka të drejtë që ky komision dhe a duhet të bëhet pagesa që u shku si propozim, mirë ishte me pas se at propozim dhe a duhet me ju ba pagesë dhe a është e ligjëshme, por me ba një shkresë për MAPL për shkak se duhet me ju vazhdu afati i komisionit dhe që kanë përfunduar punën që sa vite, mirë ishte me diskutu edhe një herë me anëtarët e kuvendit dhe me përfundu, faliminderit.

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – Edhe njëherë çka duhet me ba.

Brahim Osmani - Le të vazhdon me pagesë.

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – Logjikisht pse me ju pagu, sepse ata nuk bajnë kurgja dhe marrin rrogë, edhe vendimi kur është bërë komisioni është dashtë ndryshe me u ba, por është pagua ashtu qysh u pagu, derisa ata nuk bajnë kurgja, duhet me ju ndërpre, vendos kuvendi këtë punë sepse ata tash e kanë një listë rezervë edhe e kanë, nëse e hapin një rrugë të re ose një shesh të rij, mund të marrin një vendim, në parim

nuk kanë kurfar pune të përditëshme ose përjavëshme, as mujore nuk i kanë, e qojmë në kuvend dhe e diskutojmë, urdhëro Arian.

Arian Imeri – Deshta me sqaru që në bazë të rrogave që kanë marr ose që ju ka përfundu, ideja e kontratës ka qenë me ju vazhdu, në seancën e kaluar ka qenë me ju vazhdu kontrata.

Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi – Herën e kalume nuk është diskutu, por vendim për futjen e emrave në sistemin ARIS, është tjetër komision, nuk është ai.

Arian Imeri – Krejtë është te puna e pagesës, kur t'iu përfundon kontrata ju përfundon edhe pagesa.

Procesmbajtësja

Zafarshiku

Zyliha Tafarshiku

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



Xhavit Zariqi